VENDIM
Nr.1073, datë 23.7.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN E STATUSIT TË ZHVILLUESIT TË ZONËS EKONOMIKE NË SHKODËR, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET BASHKISË SË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 "Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike", dhe të neneve 4, pika 1, shkronja "g", 5, pikat 1 e 3, e 23, pika 3 shkronja "b" të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet"me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike, në Shkodër, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 5 për qind të pikëve, për rezultatin ekonomik, financiar, teknik dhe mjedisor, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet bashkisë së Shkodrës.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha